



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE **TË GJIMNAZIT**

MODULI: Të Folurit në Publik

Tiranë, 2016



I. HYRJE

Kurrikula e re e gjimnazit përbëhet nga kurrikula bërthamë dhe kurrikula me zgjedhje.

Kurrikula me zgjedhje synon:

- plotësimin e nevojave dhe të interesave të nxënësve, të paplotësuara me kurrikulën bërthamë;
- rritjen e aftësive psiko-sociale të nxënësve;
- orientimin e nxënësve për karrierën dhe për jetën;
- përforcimin e njohurive dhe të aftësive sipas fushave të kurrikulës bërthamë.

Këtij qëllimi i shërben edhe moduli i mëposhtëm. Ai mund të ofrohet nga shkollat në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje, me qëllim që të aftësojë nxënësit për të folur në publik.

Elementet bazë të strukturës së modulit janë:

- **Titulli i modulit** tregon fushën ku janë fokusuar veprimtaritë e nxënësve gjatë trajtimit të modulit.
- **Qëllimet e modulit** shprehin kompetencat kryesore që do të zhvillohen te nxënësit me përfundimin e suksesshëm të veprimtarive të modulit.
- **Kohëzgjatja e modulit** tregon se në sa orë mësimore do të trajtohen veprimtaritë mësimore të të gjitha rezultateve të të nxënësit.
- **Rezultati i të nxënësit** tregon arritjet (teorike dhe praktike) e pritshme të nxënësit në përfundim të veprimtarive mësimore.
- **Përmbajtja** përshkruan aspektet teorike dhe praktike, të cilat rekomandohet të trajtohen gjatë zbatimit për të mundësuar arritjen e rezultateve të të nxënësit.
- **Kriteret e vlerësimit** shërbejnë si “standarde” që mundësojnë krahasimin e arritjeve reale të nxënësve, me ato që priten të arrihen.
- **Udhëzime për zbatimin e modulit** përmbajnë disa rekomandime të përgjithshme për organizimin dhe për zbatimin e modulit, si dhe për vlerësimin e nxënësve.
- **Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit** përmbajnë listën e burimeve të të nxënësit dhe të mjeteve mësimore, të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin e modulit .

II. Moduli: TË FOLURIT NË PUBLIK

Përshkrimi: Gjatë gjithë historisë, njerëzimi e ka përdorur të folurit në publik si një mënyrë komunikimi për të bërë publike idetë, për t'i ndarë këto ide me njerëzit e tjerë, si dhe për të ndikuar tek ata. Në këtë modul do të flitet për rëndësinë e të folurit në publik dhe do të analizohen faktorët që ndikojnë në përgatitjen dhe në mbajtjen e një fjalimi ose prezantimi të mirë para publikut. Që një komunikim i tillë të jetë efikas, duhen njohur mirë elementet që përfshihen gjatë një ndërveprimi të tillë. Analiza e dëgjuesit (audiencës), puna përgatitore, përzgjedhja e temës, hartimi i fjalimit ose i prezantimit në mënyrë të strukturuar, mposhtja e ankthit të skenës dhe arti i të bindurit janë disa nga çështjet që do të trajtohen në këtë modul.

Qëllimet:

Në përfundim të këtij moduli, nxënësit:

- do të vlerësojnë rëndësinë e të folurit në publik në jetën personale, profesionale dhe sociale të individit;
- do të aftësohen për të qenë folës dhe dëgjues etik të mesazheve të ndryshme;
- do të përdorin elementet kryesore për të dhënë një mesazh logjik dhe të organizuar;
- do të dallojnë dhe do të përdorin lloje të ndryshme fjalimesh ose prezantimesh (informuese, bindëse dhe për raste të veçanta);
- do të realizojnë fjalime ose prezantime (individualisht dhe në grup), që janë në përshtatje me qëllimin, situatën dhe dëgjuesin;

Kohëzgjatja e modulit: 36 orë mësimore

REZULTATET E TË NXËNIT	PËRMBAJTJA DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT
Nxënësi gjykon për rëndësinë e të folurit në publik.	1. Çfarë është të folurit në publik dhe cila është rëndësia e tij? ☞ Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">- Çfarë është të folurit në publik? Për çfarë shërben të folurit në publik?- Të folurit në publik si një proces komunikimi.- Historia e të folurit në publik.- Të respektosh etikën gjatë të folurit.- Ndryshimet mes të folurit në publik dhe diskutimeve të

	<p>zakonshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimi i ankthit dhe i frikës gjatë të folurit në publik. Strategjitë dhe mënyrat. <p>☞ Kriteret e vlerësimit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan rëndësinë e të folurit në publik në jetën personale, profesionale dhe shoqërore; - analizon elementet e komunikimit gjatë të folurit në publik; - veçon disa momente që dëshmojnë historinë e të folurit në publik; - dallon disa tipare që dëshmojnë respektimin e etikës gjatë të folurit në publik (sinqeriteti, shmangia e fyerjeve dhe e formave të tjera denigruese, vëmendja etj.); - vlerëson respektimin e etikës gjatë të folurit; - krahason të folurin në publik me diskutimet e zakonshme; - veçon disa strategji dhe mënyra që shërbejnë për të shmangur ankthin dhe frikën gjatë të folurit.
<p>Nxënësi vlerëson rolin e audiencës gjatë përgatitjes dhe prezantimit të një fjalimi.</p>	<p>2. Analiza e audiencës</p> <p>☞ Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të folurit me në qendër dëgjuesin (audiencën). Përqendrimi në nevojat e dëgjuesit. - Mbledhja e informacionit për të analizuar audiencën. - Përshtatja me dëgjuesin (audiencën) gjatë një fjalimi ose prezantimi. <p>☞ Kriteret e vlerësimit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton rolin e audiencës në përgatitjen dhe në hartimin e një prezantimi; - njeh dhe përcakton situatën dhe audiencën (audiencën) e tij gjatë një prezantimi; - veçon mënyrat ose rrugët që përdoren për t'iu përshtatur

	audiencës (dëgjuesve).
Nxënësi gjykon për rëndësinë e të dëgjuarit gjatë komunikimit.	<p>3. Të dëgjuarit dhe reagimi (feedback)</p> <p>☞ Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rëndësia e aftësive të të dëgjuarit. - Përmirësimi i të dëgjuarit. - Aftësitë për të mbajtur shënime. - Llojet e ndryshme të të dëgjuarit. <p>☞ Kriteret e vlerësimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - veçon karakteristikat e një dëgjuesi të mirë; - analizon rrugët që çojnë në përmirësimin e të dëgjuarit; - mban shënime idetë kryesore gjatë të dëgjuarit; - përcakton karakteristikat e llojeve kryesore të të dëgjuarit (të dëgjuarit për të kuptuar një tekst, të dëgjuarit vlerësues, të dëgjuarit emfatik, të dëgjuarit kritik etj.).
Nxënësi njih rregullat për formulimin e temës, qëllimeve dhe ideve kryesore. Ai përcakton temën, qëllimet dhe idetë kryesore të një fjalimi.	<p>4. Përzgjedhja e temës, e qëllimeve dhe e ideve kryesore të fjalimit ose të prezantimit.</p> <p>☞ Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tema e një fjalimi ose e një prezantimi. - Qëllimet kryesore dhe specifike të një fjalimi ose prezantimi. - Përcaktimi i idesë kryesore. <p>☞ Kriteret e vlerësimit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh një temë interesante dhe të përshtatshme për të, duke përdorur një stuhi mendimi; - përcakton qëllimin kryesor të një ligjërata ose të një fjalimi; - përcakton qëllimet specifike të një ligjërata ose fjalimi duke zbatuar rregullat për formulimin e tyre; - përcakton idetë kryesore duke zbatuar rregullat për formulimin e tyre.
Nxënësi zbaton procesin e kërkimit para përgatitjes	<p>5. Kërkimi për një fjalim</p> <p>☞ Përmbajtja</p>

<p>dhe prezantimit të një fjalimi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Strategjitë dhe llojet e kërkimit. - Burimet e besueshme. - Materialet mbështetëse. - Kërkime në internet. - Citimi i burimeve gjatë një fjalimi. <p>☞ Kriteret e vlerësimit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - veçon disa burime të besueshme që mund të përdorë për të përgatitur një fjalim (enciklopedi, katalogë, periodikë, atlase, botime shkencore etj.); - përdor motorët e kërkimit, si një mjet për të kërkuar informacione rreth prezantimit; - veçon materialet mbështetëse që përdoren për të mbështetur idetë e folësit; - dallon llojin e materialit mbështetës (shembuj, statistika ose të dhëna, dëshmi dhe citime).
<p>Nxënësi dallon dhe përdor elementet e strukturës së një fjalimi.</p>	<p>6. Organizimi dhe struktura e një fjalimi</p> <p>☞ Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Struktura standarde e fjalimit (hyrja, zhvillimi dhe mbyllja). - Hyrja e fjalimit, roli dhe objektivat që duhen arritur. - Zhvillimi i një fjalimi, parimet. - Mbyllja e fjalimit. <p>☞ Kriteret e vlerësimit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe përdor mënyrat e duhura për të nisur një fjalim; - dallon dhe përdor mënyrat e duhura për t'iu përmbajtur temës dhe qëllimit gjatë një fjalimi; - dallon dhe përdor mënyrat e duhura për të mbyllur një fjalim.
<p>Nxënësi përdor mjete të ndryshme stilistike për t'i dhënë të folurit gjallëri</p>	<p>7. Gjuha dhe stili</p> <p>☞ Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjuha e gjallë dhe shprehëse.

<p>dhe shprehësi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Respektimi i rregullave të gramatikës dhe të shqiptimit gjatë të folurit. - Rëndësia e etikës gjatë të folurit. - Patosi dhe emocionet gjatë të folurit. <p>☞ Kriteret e vlerësimit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon dhe përdor mjetet stilistike që i japin shprehësi gjuhës në një fjalim; - respekton rregullat e gramatikës dhe të shqiptimit gjatë të folurit; - vlerëson dhe përdor një gjuhë që i përmbahet rregullave të etikës dhe që shmang diskriminimet gjinore, të racës, të fesë etj.
<p>Nxënësi analizon kategoritë e ndryshme të shpërndarjes së një fjalimi dhe vlerëson rolin e komunikimit joverbal gjatë një fjalimi.</p>	<p>8. Shpërndarja e fjalimit</p> <p>☞ Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Katër kategoritë e shpërndarjes së një fjalimi. - Roli i komunikimit joverbal gjatë të folurit. <p>☞ Kriteret e vlerësimit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon kategoritë e shpërndarjes së një fjalimi (me shkrim, i improvizuar etj.); - analizon dhe vlerëson rolin e komunikimit joverbal gjatë një fjalimi (lëvizjet e trupit, gjestet, komunikimi me sy).
<p>Nxënësi vlerëson rëndësinë e mjeteve pamore që përdoren gjatë një fjalimi ose prezantimi.</p>	<p>9. Përfshirja dhe përzgjedhja e elementeve pamore që përdoren gjatë një fjalimi ose prezantimi</p> <p>☞ Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Llojet e mjeteve pamore që përdoren gjatë një fjalimi dhe rëndësia e tyre. - Avantazhet dhe disavantazhet e Power- Point-it. - Përgatitja e mjeteve pamore.

	<p>☞ Kriteret e vlerësimit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon mjetet pamore që mund të përdoren gjatë një fjalimi ose prezantimi (grafikë, tabela, pamje etj.); - vlerëson rëndësinë e këtyre mjeteve në një fjalim; - përdor mjete të ndryshme pamore gjatë një fjalimi.
<p>Nxënësi analizon tiparet e fjalimeve informuese dhe bindëse.</p>	<p>10. Llojet e fjalimeve</p> <p>☞ Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fjalime informuese. - Fjalime bindëse. - Fjalime për raste të veçanta. <p>☞ Kriteret e vlerësimit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon tiparet e fjalimeve informuese; - dallon tiparet e fjalimeve bindëse dhe veçon metodat e bindjes që përdoren në raste të tilla; - dallon tiparet e fjalimeve për raste të veçanta si p.sh., me rastin e marrjes së një çmimi, me rastin e një feste etj. - harton një fjalim informues, një fjalim bindës dhe një fjalim për raste të veçanta.
<p>Nxënësi vlerëson aftësitë e tij dhe të tjerëve për t'u shprehur qartë dhe saktë në situata dhe për qëllime të ndryshme.</p>	<p>11. Vlerësimi i të folurit</p> <p>☞ Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vetëvlerësimi i aftësive të të folurit. - Vlerësimi i aftësive të tjerëve gjatë të folurit. <p>☞ Kriteret e vlerësimit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon tiparet e tij si folës; - përcakton mënyrat që duhen përdorur për të përmirësuar aftësitë e tij gjatë të folurit ; - vlerëson anët pozitive të tij dhe të tjerëve gjatë të folurit.

III. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E MODULIT

Për realizimin e modulit, mësuesit duhet të përdorin, sa më shumë të jetë e mundur, diskutimet, debatet, punën në grupe, veprimtaritë konkrete, projektet, konkurset. Kjo formë mësimdhënieje i ndihmon nxënësit t'i përshtatin lehtësisht njohuritë në praktikë. Në fund të modulit, çdo nxënës mund të prezantojë një fjalim para një publiku me mësues, nxënës, prindër, anëtarë të komunitetit etj.

Realizimi i mësimit ka rëndësi parësore për arritjen e rezultateve të parashikuara të nxënësit. Për këtë sugjerohet që mësuesi të planifikojë mësimin, duke mbajtur parasysh rezultatet mësimore të parashikuara në programin e modulit, si dhe të shpjegojë termat dhe konceptet kryesore duke i vënë theksin te zbatimi në praktikë i tyre.

Mësuesi për realizimin e modulit duhet të pozicionohet më tepër në rolin e moderatorit, se sa të mësuesit tradicional.

IV. KUSHTET E DOMOSDOSHME PËR REALIZIMIN E MODULIT

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen materialet, mjediset, pajisjet e mëposhtme:

- materialet të printuara dhe digjitale;
- laptopë, kamera, pajisje regjistrimi dhe projektor;
- modele të mira fjalimi si p.sh., fjalimi i Martin Luther King-ut “Unë kam një ëndërr”, fjalimi i Ismail Kadaresë me rastin e marrjes së çmimit “Jerusalem” etj.;
- në disa orë mësimi, moduli mund të zhvillohet në salla, biblioteka dhe mjedise të tjera në shkollë dhe jashtë saj, me qëllim që nxënësit t'u ushtrohen për të folur në publik.